

Treguesit Gjeografikë dhe përdorimi produktit si kolateral nga institucionet financiare dhe mikrofinanciare

Në një epokë ku tregjet globale po bëhen gjithnjë e më konkurruese, ruajtja dhe mbrojtja e produkteve tradicionale dhe autentike merr një rëndësi të veçantë. Një nga mënyrat më efektive për të siguruar këtë mbrojtje është përmes treguesve gjeografikë, të cilët nuk janë thjesht etiketa, por simbole të cilësisë dhe autenticitetit që lidhen ngushtë me një zonë të caktuar gjeografike. Përderisa markat tregtare përfaqësojnë një kompani të caktuar, treguesit gjeografikë përmes një grupi të prodhuesve përfaqësojnë rajonin dhe shtetin për nga vijnë. Për këtë, shumë shtete përkrahin grupet e prodhuesve të produkteve të caktuara të cilat përmes cilësisë, veçorive karakteristike të prodhimit, njohurive të trashëguar ndër vite ose shekuj, përfaqësojnë denjësisht kulturën dhe traditën e rajonit dhe të shtetit.

Përderisa në shtetet e Bashkimit Europian ekzistojnë fonde të caktuara kombëtare për përkrahje të grupeve të prodhuesve të produkteve tradicionale, Kosova siç duket as nuk e ka në prioritet një gjë të tillë. Si pasojë, disa produkte mund të mos prodhohen, dhe si të tilla të zhduken në të ardhmen.

Me përkrahjen financiare të Ambasadës së Republikës së Francës në Kosovës, me mbështetjen në ekspertizë të ekspertëve Francez dhe vendorë të Institutit Kosovar për Pronësi Intelektuale, dhe mbështetjes Ligjore të kompanisë së Avokatit LexTrust LLC, pas një periudhe gati 10 vjeçare është bërë e mundur të kemi një produkt të mbrojtur me Emërtim të Origjinës në Kosovë. Produkt ky i cili do të jetë shembull për çdo aplikim tjetër vendor, dhe një shpresë se me përkrahjen e duhur, fermerët tanë, prodhuesit tanë, do të jenë përfaqësimit më i mirë në botë i traditës, i kulturës dhe njohurive shekullore.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade
Agjencia për Pronësi Industriale - Agency for Industrial Property

Nr regj: 01
Nr : KS/TGJ-EO/2020/4699
Data regi: 17/05/2023

V E N D I M
për regjistrimin Emërtim i Origjinës,

Sipas Nenit 6, Nenit 15 të Ligjit Nr. 05/L-051 për Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Origjinës, dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MTI) nr. 11/2016 për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, Agjencia e Pronësisë Industriale ju informon se kushtet për regjistrimin janë plotësuar dhe regjistrimin e treguesit të mbrojtur gjeografikë, si vijon:

| | |
|---|---|
| (1) Numri i Aplikimi: | KS/TGJ-EO/2020/4699 |
| (2) Numri i Regjistrimit | 01 |
| (3) Emri i Treguesit Gjeografik | Djathi i Sharrit |
| (4) Emri / Adresa e Shoqatës: | Shoqata e Prodhuesve të Djathit të Sharrit, Rr. Ilaz Kuka Nr. 21, 20000, Prizren, Kosovë |
| (5) Emri / Adresa e Përdoruesit të Autorizuar | Veli Hoti, LexTrust LL.C. Rr. Hajrullah Abdullahu Nr. 35/13, 10000, Prishtinë, Kosovë hoti@lextrust-ks.com Tel: 049607093 |
| (8) Data e përfundimit të mbrojtjes: | 12/08/2030 |
| (9) Data dhe numri i publikimit: | 29/12/2022 Nr. 107 |

ARSYETIM

Në bazë të Ligjit Nr. 05/L-051 për Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Origjinës, dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MTI) nr. 11/2016 për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës dhe në bazë të kërkesës me numër 4699 deponuar më 12/08/2020 regjistrohet treguesi gjeografik me numër aplikimi 4699/2020 siç është paraqitur në dispozitiv.



Djathi i Sharrit është ndër produktet më orgjinale në Kosovë. Ky djath është i njohur për shijen e tij të veçantë dhe cilësinë e lartë, e cila lidhet ngushtë me kushtet natyrore dhe klimën e rajonit ku prodhohet, meqenëse vie nga një regjion ku bimësia është e pasur dhe ajri i pastër, së bashku me njohuritë, metodat dhe mënyrën tradicionale kontribuojnë në cilësinë e tij unike.

Djathi i Sharrit është Emërtimi i Parë i Origjinës i Regjistruar ndonjëherë në Republikën e Kosovës dhe në Historinë e Kosovës. Kjo mund të vërehet se Numri i Vendimit është Nr. Regj: 01, Nr. KS/TGj-EO/2020/4699.

Sipas legjislacionit vendor, Ligjit Nr. 05/l-051 për treguesit gjeografik dhe për emërtimet e origjinës në Kosovë por dhe legjislacionit të BE-së, emërtimet e origjinës janë emra ose simbole që identifikojnë një produkt si origjinë nga një zonë e caktuar gjeografike, ku cilësitë specifike të produktit janë kryesisht të ndikuara nga mjedisi gjeografik i asaj zone, kanë për qëllim të mbrojnë produktet unike që lidhen me një vend ose rajon specific, që përveç vendndodhjes gjeografike përfshijnë dhe faktorë të veçantë tradicionalë të prodhimit. Për të marrë një emërtim të tillë, produkti duhet të ketë një lidhje të fortë dhe ekskluzive me vendin e origjinës, jo vetëm në aspektin e cilësisë, por edhe në aspektin e traditave dhe teknikave të prodhimit. Një shembull është djathi Parmigiano-Reggiano nga Italia, i cili mund të prodhohet vetëm në një zonë të caktuar dhe sipas metodave të veçanta të trashëguara ndër breza. Ndërkaq në Kosovë, si më lartë Djathi i Sharrit është shembulli më i mirë i përfaqësimit të këtyre llojeve të produkteve.

Përdorimi i Djathit të Sharrit si kolateral

Por si mundet që Djathi i Sharrit të jetë produkti i parë në Kosovë edhe për një aspekt tjetër të qasjes në financa për fermerët?

Të gjithë ata që kanë dëgjuar për Parmigiano, e dijnë që Parmigiano është rajon në Italy dhe që djathi i prodhuar në Itali nga ky rajon ka këtë emërtim, i cili është i mbrojtur me tregues gjeografikë. Ata që kanë përcjellë lojrat Olimpike të vitit 2024 kanë mund të vërejnë fotografitë e gjimnastit Giorgia Villa, e cila ishte sponsorizuar nga Parmesan ose Parmigiano. [photo source Instagram: giorgiavilla23]



Që nga viti 1953, banka rajonale Credito Emiliano ka pasur një kthesë të fortë në kreditë e bizneseve të vogla duke pranuar "bukët" e rumbullakëta të djathit Parmigiano-Reggiano si kolateral. E njohur në vend si Credem, banka tani është paraqitur në një rast studimi të Shkollës së Biznesit të Harvardit të titulluar "Credem: Banking on Cheese". [source: Forbes, A Bank That Accepts Parmesan as Collateral: The Cheese Stands A Loan]

Rasti me Parmigiano dhe Bankën Credito Emiliano është në kuadër të riskut që institucioni financiar merr mbi vete me rastin e kredihënies, por në shtetet si Brazili dhe Ukraina, kjo gjë është më se normale, dhe për më tepër është e rregulluar me ligje specifike. Kosova së fundmi ka marr për shembuj këto shtete dhe shumë shtete të tjera të cilat janë duke u mundësuar mënyra inovative fermerëve për të pasur qasje në financa.

Qeveria e Kosovës në vitin 2023, me asistencën profesionale dhe këshilldhënëse të Korporatës Financiare Ndërkombëtare, pjesë e Grupit të Bankës Botërore, ka aprovuar projektligjin i cili ka për qëllim që të rregulloj



dy instrumente financiare për të siguruar financimin e kapitalit qarkullues për sektorin e bujqësisë dhe përcakton bazën ligjore dhe ekonomike, parimet dhe rregullat e nxjerrjes, regjistrimit publik, vendosjes dhe qarkullimit të tyre në Kosovë. Projektligji nr.08/I-278 për faturat e kulturave bujqësore dhe fletëmagazinave gjendet në procedurat e aprovimit në Kuvend, dhe urojmë që të aprovohet para se të shkohet në zgjedhjet e dates 9 Shkurt 2025 si të përcaktuara me Dekretin e Presidentit të Kosovës. [[Link to progress](#)]

Me miratimin e këtij ligji jo vetëm produkti i djathit i cili mund të magazinohet dhe sipas regjistrimit nga fletëhyrja në magazinë mund të përdoret si kolateral, por edhe produktet tjera bujqësore si ato të gatshme, të procesuara, të prodhuara apo të cilat do të prodhohen, do të mund të përdoren si kolateral për të marr kredi në institucionet financiare apo mikrofinanciare, apo për të pranuar çfarëdo lloj financimi tjetër nga investitorët, furnizuesit e produkteve bujqësore, apo pikat grumbulluese.

Përfundime

Në përfundim, përdorimi i Djathit të Sharrit si kolateral paraqet një mundësi inovative për prodhuesit kosovarë, duke krijuar një lidhje të re mes trashëgimisë kulturore dhe qasjes në financa. Regjistrimi i këtij produkti të parë me emërtim origjine në Kosovë, shënon një pikë të rëndësishme në mbrojtjen e produkteve tradicionale dhe zhvillimin e bujqësisë në vend. Nëse ligji i ri për faturat e kulturave bujqësore dhe fletëmagazinave miratohet në Kuvend, kjo do t'i hapë rrugë një të ardhmeje ku produktet e cilësisë së lartë, si Djathi i Sharrit, jo vetëm që do të jenë të mbrojtura dhe të promovuara në tregun evropian, por gjithashtu do të shërbejnë si një mjet i vlefshëm për të siguruar financim dhe për të ndihmuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të rajonit dhe Kosovës. Kjo qasje do të forcojë pozitën e fermerëve kosovarë, duke u dhënë atyre mundësinë të përfaqësojnë vendin me dinjitet në tregjet ndërkombëtare dhe të ruajnë trashëgiminë e pasur kulturore të Kosovës.

Përkrahja dhe mirënjohje

Në lidhje me të arriturat në regjistrimin e Djathit të Sharrit, prodhuesit kanë pasur përkrahjen e vazhdueshme të Ambasadës së Republikës së Francës në Kosovë, së bashku me shumë ekspertë francezë dhe ekspertë vendorë të Kosovo Institute of Intellectual Property, dhe përfaqësuesit ligjor të Shoqatës së prodhuesve të Djathit të Sharrit – firmës së avokatit Avokatit LexTrust LLC. Hapi i radhës është regjistrimi në Bashkimin Europian, dhe ndërmarrja e veprimeve doganore sipas Ligjit për nr. 06/I-015 mbi masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

